REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 243/25
Datë/Datum. 25.02.2025
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Organi Shqyrtues i Prokurimit, në pajtim me nenin 48 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe paragrafin 6, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe duke u bazuar në nenin 23 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 dhe paragrafin 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, më datë: 26/02/2025 publikon këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

Për pranimin e aplikimeve për një (1) ekspert i jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese

1. Kandidatët për ekspert i jashtëm të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, në pajtim me dispozitat e nën paragrafit 2.3 paragrafit 2 të nenit 23 të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

   - të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi;
   - të kenë katër (4) vite përvojë pune në pozita të nivelit drejtues;
   - të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
   - të kenë integritet moral dhe profesional;
   - të mos kenë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos kenë qenë të dënuar për kryerjen e një vepre penale jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
   - të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

2. Për Kandidatët për ekspert i jashtëm të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, duhet të dorëzohen dokumentet në vijim:

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për diplomat e pranuara jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale në pozitat e nivelit drejtues;
- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës (me afat të vlefshëm me rastin e aplikimit).

Kandidatët për ekspert i jashtëm për kategorinë e lartë drejtuese si personalitet i pavarur në Komisionin e Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për procedurë të rekrutimit, në pajtim me dispozitat e nenit 23 paragrafit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurat e Pranimit në Shërbimin Civil.

Afati për dorëzimin e CV-së, dhe dokumenteve përcjellëse sipas pikët 1 dhe 2 të kësaj thirrje publike për anëtar të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, është i hapur nga data: 26/02/2025 deri më datë: 05/03/2025.
Mandati i ekspertit të jashtëm është për procedurën e rekrutimit të kategorisë së lartë drejtuese në Organin Shqytues të Prokurimit me nr. Reference RN00016792.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta.
Kandidatët e interesuar për aplikim për ekspert i jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: arta.S.berisha@rks-gov.net

Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038/212-360 ose në email adresën: arta.S.berisha@rks-gov.net

Ju faleminderit!